

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.10.2024*

**18.10.2024
Ora 13:12**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zotit Erjon Shërbet Meka, kandidat i listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. Pavlina Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme kemi në rend dite, plotësimin e një vakance në Kuvendin e Shqipërisë. Po!

Znj. P. Doçaj: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, nga zoti Jurgis Shefqet Çyrbja, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 408, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.10.2024*

deputetit, është kandidati me numër rendor njëmbëdhjetë, zoti Erjon Shërbet Meka. Kandidati për deputet, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda afateve ligjore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore të zotit Erjon Meka, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, zotit Erjon Meka, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë e tij në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimin përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere, vendos:

- Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të rradhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, zotit Erjon Meka.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Vendimi nr. 191

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

